



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>DPK</u>	Nr Prot Bi Prot Prot/No <u>03-02/1270/18</u>
Nr i fac. Broj str. ulica Nr. pages <u>03</u>	Data Datum <u>02-05-2018</u>
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 26.04.2018, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-3656/17, për z. Adem Nura, Drejtor i Qendres Kombëtare të Mjekësisë Sportive të Qendres Klinike dhe Universitare të Kosovës, për shkak se zyrtari i lartë e ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Adem Nura, Drejtor i Qendres Kombëtare të Mjekësisë Sportive të Qendres Klinike dhe Universitare të Kosovës, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Pas informatës së marrë nga raportuesi i rasti sipas të cilit z. Adem Nura dyshohet se ka konflikt interesi sepse ushtron njëkohësisht edhe funksionet Anëtar i Këshillit Drejtues në Universitetin Publik "Isa Boletini" – Mitrovicë, Kryetar i Kryqit të Kuq të Kosovës, dhe Profesor në Fakultetin e Mjekësisë Sportive të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina".

Agjencia kundër Korrupsionit, fillimisht e ka njoftuar zyrtarin e lartë me një shkresë zyrtare për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Pas pranimit të kësaj

shkresë është organizuar një takim me zyrtarin e lartë. gjatë këtij takimi z. Nura, është njoftuar me fakte se gjatë ushtrimit të funksionit Drejtor i Qendres Kombëtare të Mjekësisë Sportive të Qendres Klinike dhe Universitare të Kosovës nuk mund të ushtroj njëkohësisht edhe funksionin Kryetar i Kryqit të Kuq të Kosovës sepse Ligji nr.05/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të interesit e ndalon një gjë të tillë, neni 16 (paragrafi 1) në të cilin shprehimisht thuhet;

“Zyrtari i lartë publik nuk mund të jetë menaxhues ose anëtar i organeve menaxhuese në organizata fitimprurëse dhe jo fitimprurëse, përjashtuar subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet për shkak të funksionit”.

Agjencia i ka dërguar shkresë paralajmëruese zyrtarit të lartë, me të cilën i është kërkuar të shmang konfliktin e interesit brenda afatit ligjore, përndryshe Agjencia është e obliguar të veproj konform nenit 18 paragrafi 8 të Ligjit nr.04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Ndërkohë, Agjencia ka pranuar shkresën zyrtare (DPKI.03-02/818/18) me të cilën dëshmohet se zyrtari i lartë ka dhënë dorëheqje nga funksioni Kryetar i Kryqit të Kuq të Kosovës.

Ndërsa, Ushtrimi i funksionit Drejtor i Qendres Kombëtare të Mjekësisë Sportive të Qendres Klinike dhe Universitare të Kosovës dhe njëkohësisht Anëtar i Këshillit Drejtues në Universitetin Publik “Isa Boletini” – Mitrovicë nuk paraqet konflikt interesi, mirëpo zyrtari i lartë duhet ti ushtrojë nën kufizimin e përcaktuar të Ligjit nr.04/L-051 për Parandalimin e konfliktit të interesit neni 15 (paragrafi3) në të cilin thuhet;

“Zyrtari i lartë në cilësinë e anëtarit të organeve drejtuese dhe mbikëqyrës i personave juridik jo fitimprurës dhe personave juridik tjerë të cilat kryejnë punë nga lëmi i shkencës, sportit, arsimit, kulturës dhe veprimtarive humanitare, por nuk ka të drejtë të pranimit të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve tjera të nevojshme, për veç nëse nuk parashihet ndryshe me ligje tjera”.

Ushtrimi i funksionit Drejtor i Qendres Kombëtare të Mjekësisë Sportive dhe njëkohësisht Profesor në Fakultetin e Mjekësisë Sportive të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” nuk paraqet konflikt interesi duke u bazuar në Vendimin e Këshillit Drejtues nr.2/901 dhe ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit 996, sepse me këto Vendime është rregulluar vetëm qështja e përcaktimit të pagës primare dhe sekondare për personelin akademik që mbajnë poste jashtë Universitetit të Prishtinës. Prandaj e drejta e ushtrimit të këtyre dy funksioneve është vendosur edhe me Aktgjykim të Gjykatës Kompetente.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.



Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

